KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
Nr. III-263 Data 13.09.2022
Br. Datum

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
**KOMUNA E OBILIQIT**
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

Duke u bazuar në nenin 34 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 13 të Statutit të Komunës së Obiliqit nr.I-34 datë 25.04.2016, në nenin 6 të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Obiliqit nr. I-75 datë 30.05.2022 dhe Vendimin nr.I-105 datë 28.07.2022 për Themelimin e Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane, Komisioni përmes Zyrës për Informim me datë 13.09.2022 lëshon këtë:

**NJOFTIM**
**Për Zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane në Komunën e Obiliqit**

Komuna e Obiliqit me datë 03.10.2022, fillon me procesin e zgjedhjes së Këshillave të Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane në Komunën e Obiliqit.
Takimet mbahen në lokalitetet e përshkruara në tabelën më poshtë dhe janë të hapura për të gjithë banorët e lokaliteteve në të cilat mbahen.
Inkurajohen të gjithë qytetarët veçanërisht gratë dhe vajzat që të marrin pjesë në takimet për zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane në Komunën e Obiliqit.
Në takimet e cekura më lartë do të jetë ky:

**REND DITE**

1. Zgjedhja e Këshillit të Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane në Komunën e Obiliqit;
2. Zgjedhja e Kryetarëve dhe anëtarëve të Këshillave dhe
3. Të ndryshme.

Në komunën e Obiliqit duke u bazuar në nenin 11 të Statutit të Komunës së Obiliqit nr.I-34 datë 25.04.2016 dhe nenin 5 të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Obiliqit nr. I-75 datë 30.05.2022, janë gjithsej 18 vendbanime të cilat janë të ndara në 12 zona përkatësisht këshilla.
Takimet për zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane në Komunën e Obiliqit, do të organizohen në vendet dhe datat si më poshtë:

| Nr. | Zona | Fshati / Vendbanimi / Lagja | Vendi i Takimit | Data | Ora |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Zona 1 | Obiliq- Qendër | Shfmu "Dr.Ibrahim Rugova" | 12.10.2022 | 17:00 |
| 2. | Zona 2 | Obiliq i Vjetër | Shfmu "Pandeli Sotiri" | 11.10.2022 | 17:00 |
| 3. | Zona 3 | Mazgit i Ulët, Mazgit i Lartë, Shkabaj (Hade e Re) | Shfmu "Dr.Ibrahim Rugova" Paralelja e ndarë | 10.10.2022 | 17:00 |
| 4. | Zona 4 | Kryshevc (Dardhishtë) | Shfmu "Abdurrahman Gërguri" | 07.10.2022 | 17:00 |
| 5. | Zona 5 | Llazarevë, Bashki dhe Raskovë | Shfmu "Hasan Prishtina" Paralelja e ndarë | 06.10.2022 | 17:00 |
| 6. | Zona 6 | Milloshevë | Shfmu "Hasan Prishtina" | 05.10.2022 | 17:00 |
| 7. | Zona 7 | Babimoc | Shtëpia e Kulturës | 04.10.2022 | 17:00 |
| 8. | Zona 8 | Breznicë dhe Kozaricë | Shfmu "Naim Frashëri" | 03.10.2022 | 17:00 |
| 9. | Zona 9 | Plemetin | Shfmu "Pandeli Sotiri" Paralelja e ndarë | 13.10.2022 | 17:00 |
| 10. | Zona 10 | Siboc dhe Hamidi | Shfmu "Migjeni" | 14.10.2022 | 17:00 |
| 11. | Zona 11 | Graboc i Epërm dhe Shipitullë | Shfmu "Migjeni" Paralelja e ndarë | 17.10.2022 | 17:00 |
| 12. | Zona 12 | Hade, Leshkoshiq dhe Caravodicë | Shfmu "Fazli Grajqevci" Paralelja e ndarë | 18.10.2022 | 17:00 |

Në takimet e sipër cekura janë të ftuar të marrin pjesë edhe organizatat e shoqërisë civile të cilat monitorojnë punën e komunave.

Komisioni për zgjedhjen e këshillave të fshatrave do të punojë në bazë të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, Rregulloren për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Obiliqit nr. I-75 datë 30.05.2022 dhe Vendimin nr.I-105 datë 28.07.2022 për Themelimin e Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane.

Lendita Bekteshi – Memishi
Kryetare e Komisionit

I-95 29.06.2022

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosova**
**Qeveria - Vlada - Government**
**Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq**

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008),nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës, nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, nenit 4 të Rregullores nr.-I-75, të dt. 30.05.2022, për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Obiliqit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës së DAP-së, nr.-III-169, të dt.20.06.2022, në mbledhjen e mbajtur me dt.29.06.2022, mori këtë:

# VENDIM

1. Formohet Komisioni për përzgjedhjen e Këshillave lokale me këta anëtarë:
   1. Naim Miftari, Kryetar i Komisionit (Ekzekutivi i Komunës)
   2. Fidan Ahmeti, anëtar i Kuvendit (IQO)
   3. Enver Gashi, anëtar i Kuvendit (IQO)
   4. Albana Shillova Shalaku, anëtare e Kuvendit (LVV)
   5. Valbonë Beka, anëtare e Kuvendit (LB)
   6. Zelushe Kelmendi, nga shoqëria civile
   7. Përfaqësuesi nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e Këshillit lokal

2. Detyrat e Komisionit janë të caktuara në Rregulloren (KO) 03/2022 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunmës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Obiliqit.

3. Obligohet Komisioni që për punën e vetë të përgatitë procesverbal me shkrim dhe për këtë ta njoftoj Kuvendin komunal.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

**Kryesuesja e Kuvendit Komunal**

**Vlora Mjekiqi-Kabashi**

T'idërgohet
-Kryetarit
-Nënkryetarit
- Kryesueses
-MAPL
-Anëtarëve të Komisionit
-Anëtarëve të KK
-Arkivit

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izlazne
Nr.-Br. 1-105 Data-Datum 28.07.2022
OBILIQ-OBILIĆ

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosova**
**Qeveria - Vlada - Government**
**Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq**

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008),nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës, nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, nenit 4 të Rregullores nr.-I-75, të dt. 30.05.2022, për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Obiliqit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.-II-982, të dt.21.07.2022, në mbledhjen e mbajtur me dt.28.07.2022, mori këtë:

# VENDIM

1. Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.-I-95, i dt.29.06.2022, i Komisionit për përzgjedhjen e Këshillave lokale me këta anëtarë:

1.1 Lendita Bekteshi Memishi, drejtoreshë e DAP-së në vend të Naim Miftarit,
1.2 Debora Peci, nga Demokracia plus në vend të Zelushe Kelmendit nga shoqëria civile
1.3 Valon Svirca, anëtar i Kuvendit (LVV) në vend të Albana Shillova Shalakut, anëtare e Kuvendit (LVV)

2. Anëtarët tjerë të Komisionit mbeten si kanë qenë dhe atë:

4. Fidan Ahmeti, anëtar i Kuvendit (IQO)
5. Enver Gashi, anëtar i Kuvendit (IQO)
6. Valbonë Beka, anëtare e Kuvendit (LB)
7. Përfaqësuesi nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e Këshillit lokal

3. Detyrat e Komisionit janë të caktuara në Rregulloren (KO) 03/2022 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunmës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Obiliqit.

4. Obligohet Komisioni që për punën e vetë të përgatitë procesverbal me shkrim dhe për këtë ta njoftoj Kuvendin komunal.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T'idërgohet
-Kryetarit
-Nënkryetarit
-Kryesueses
-MAPL
-Anëtarëve të Komisionit
-Anëtarëve të KK
-Arkivit

**Kryesuesja e Kuvendit komunal**
**Vlora Mjekiqi Kabashi**

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E OBILIQIT
REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA OBILIĆ